



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJEN VENDORE

PROCESVERBALI I MBLEDHJES

**TAKIMI I GRUPIT TEKNIK TË PUNËS SË PERFORMANCËS LIDHUR ME
TREGUESIT E PERFORMANCËS 2024 NË FUSHËN E ARSIMIT**

Tiranë, 8 Prill 2024

Hapja e mbledhjes

Mbledhja u hap nga z. *Stiljan Llavdaniti, Drejtor i Përgjithshëm i Komanduar, AMVV* duke përshëndetur dhe falënderuar pjesëmarrësit për praninë e tyre. Ai u shpreh se qëllimi kryesor i takimit ishte reflektimi mbi aspektet pozitive të procesit të Sistemit të Performancës gjatë vitit të kaluar, si dhe identifikimi i mangësive me qëllim përmirësimin e mëtejshëm. Z. Llavdaniti theksoi se mangësitë e konstatuara vitin e kaluar do të adresohen, në mënyrë që procesi të bëhet sa më transparent dhe më i frytshëm.

Çështje të diskutuara:

Znj. Olta Caca, Drejtor i Drejtorisë së Statistikës dhe Performancës, AMVV vazhdoi me prezantimin e treguesve të performancës në lidhje me arsimin. Disa nga gjetjet kryesore të raportit vjetor ishin:

1. Çerdhet – në 17 bashki nuk ofrohen shërbime publike të çerdheve, duke përfshirë këtu bashki të vogla dhe të mesme;
2. Kopshtet publike – mesatarja kombëtare e regjistrimit për fëmijët 3–6 vjeç është 60.1%;
3. Raporti fëmijë–mësues – ky ndryshon në varësi të madhësisë së bashkive si dhe midis sektorit publik dhe atij privat;

Fillimisht u konsoliduan 40 tregues, por gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave u konsiderua e arsyeshme që disa prej tyre të ndryshoheshin. Raporti fëmijë/mësues paraqet një diferencë të konsiderueshme, megjithatë ndodhet në përputhje me vlerat mesatare të vendeve të BE-së, që është 13. Konkretisht, në kopshtet publike në Shqipëri rezulton të jenë 13 fëmijë për mësues, ndërsa në kopshtet private ky tregues zbret në 10 fëmijë për mësues.

Komente:

Znj. Denalda Kuzumi, Ekspert, Bashki të Forta u ndal në aksesin e të dhënave dhe nëse të dhënat ishin marrë nga INSTAT, por znj. Olta Caca sqaroi se ato janë siguruar nga MAS.

Znj. Majlinda Nesturi, Data Analyst, Un Women u shpreh se këto të dhëna duhet të përfshijnë edhe çerdhet private, në mënyrë që të kemi një panoramë të plotë.

Znj. Caca theksoi se qëllimi është mbledhja e të dhënave për të dyja rastet – si për institucionet private, ashtu edhe për ato publike.

Z. Endrit Xhina, Ekspert, Smart Processes theksoi se institucionet private nuk raportojnë në bashki, dhe se kopshtet private përballen me një boshllëk ligjor në këtë drejtim.

Ndërkohë, *znj. Voltana Ademi, Ekspert, Smart Processes* theksoi se informacioni mbi censin e fëmijëve sipas grupmoshave në nivel bashkie duhet të ndahet me SHBSH-në.

Znj. Olta Caca sqaroi se bashkitë janë më të orientuara drejt gjendjes civile sesa drejt INSTAT-it, dhe se shpesh kanë raportuar në mënyrë të pasaktë stafin e kopshteve, duke përfshirë edhe stafin mirëmbajtës në stafin mësimdhënës.

Në përmbyllje të kësaj pjese, *Z. Llavdaniti* u shpreh se SMP 2024 ka avantazhin e përfshirjes së strukturave të performancës në çdo bashki. Ai shtoi se, ndryshe nga viti i kaluar ku ishte caktuar një koordinator për të gjitha ndërveprimet për raportim, këtë vit procesi do të jetë më i organizuar ndryshe për shkak të këtyre njësive.

Ndërsa *Z. Xhina* theksoi se për të dhëna specifike si numri i popullsisë, në pasaportën e të dhënave, duhet të përcaktohet që si referencë do të përdoret Cens-i. *Znj. Caca* shtoi se, duke qenë se tashmë kemi të dhëna nga raportimi i vitit 2023, nëse bashkia vendos gabimisht një të dhënë të gabuar, sistemi e identifikon si të tillë dhe sinjalizon një mospërputhje me të dhënat e mëparshme.

Pas këtyre diskutimeve, *znj. Olta Caca* vijoi me prezantimin, duke shpjeguar treguesit e pandryshuar të arsimit. Në gjithë sistemin e matjes së performancës vitin e kaluar përfshiheshin **40 tregues**, ndërkohë aktualisht propozohen rreth **50 tregues**, nga të cilët rreth **30 tregues mbeten të pandryshuar**.

Lidhur me treguesit e arsimit të pandryshuar, që do të mundësojnë krahasueshmëri me të dhënat e vitit të kaluar janë:

1. **Shkalla e regjistrimit në çerdhe;**
2. **Shkalla e regjistrimit në kopshte publike dhe private;**
3. **Raporti fëmijë–mësues në kopshte.**

Komente:

Znj. Ademi u shpreh se në terren ekziston një problem me shkollat, kopshtet dhe bashkitë. Bashkitë, kur raportojnë në MAS, dërgojnë regjistrin që tregon sa fëmijë janë në kopsht sipas grupmoshave, ndërsa kur raportojnë pranë AMVV-së mund të gabojnë, çka sjell inflacion në të dhëna.

Z. Xhina theksoi se problemi kryesor nuk është vetë saktësia e të dhënave, por dualiteti i raportimit dhe koha e ndryshme kur bëhet ky raportim. ZVA-të mbledhin të dhëna drejtpërdrejt nga kopshtet dhe i raportojnë në MAS, gjatë regjistrimeve në shtator. Nga ana tjetër, bashkia i kërkon këto të dhëna në fund të vitit për qëllime planifikimi. Duke qenë se të dhënat jepen në **dy institucione të ndryshme**, në mënyrë të pavarur dhe në **dy periudha të ndryshme kohore**, kjo çon në mospërputhje mes të dhënave që raportohen në ZVA dhe atyre që raportohen në bashki.

Znj. Caca shtoi se aktualisht ekziston edhe një sistem tjetër elektronik për mbledhjen e këtyre të dhënave lidhur me arsimin parashkollor, i cili është në përdorim nga INSTAT dhe nëpërmjet bashkëpunimit mund të standartizohen keto tregues, për të patur një të dhënë të unifikuar.

Znj. Elda Muça, E

kspert, INSTAT u shpreh se ekziston një projekt për mbledhjen e këtyre të dhënave dhe se janë në fazën përfundimtare të grumbullimit të tyre.

Z. Erton Kashta, ekspert, Bashki të Forta theksoi se këta tregues duhet të formalizohen dhe mënyra se si shprehen duhet të unifikohet për të gjitha proceset. Sipas tij, të dhënat e INSTAT duhet të integrohen në të dhënat e SMP.

Znj. Kuzumi sugjeroi që të paktën tre indikatorë të analizohen më thellë, duke përcaktuar qartë ku ndodhet aktualisht procesi dhe si pritet të zhvillohet më tej. Znj. Shapo u shpreh se përkufizimi i indikatorëve duhet të jetë i njëjtë – pra, është e nevojshme të unifikohet përkufizimi për raportim.

Z. Llavdaniti u shpreh se AMVV ka dërguar një udhëzim me modelin e strukturave organizative të bashkive sipas madhësisë së tyre. Një zhvillim pozitiv që u theksua, ishte se njësitë e performancës janë bërë uniform, pavarësisht madhësisë së bashkisë.

Znj. Caca theksoi se nevoja për trajnim në lidhje me matjen e performancës është shumë e madhe për bashkitë. Nga ana tjetër, znj. Shapo u shpreh se një nga problemet e vitit të kaluar ishte periudha **shumë e shkurtër** dhe fakti që raportimi u mor përsipër nga punonjës drejtues të lartë pranë bashkive. Ajo theksoi se ky është një mësim i rëndësishëm dhe se këtë vit do të fokusohet tek njësitë përkatëse dhe personeli teknik, për të shtyrë procesin përpara në mënyrë më profesionale.

Z. Llavdaniti u shpreh se tashmë ekziston “bërthama” e njësive të performancës dhe se këtë vit kanë më shumë kohë në dispozicion.

Z. Xhina shtroi pyetjen se kur do të mbahet SMP, dhe përfaqësuesit e AMVV-së u përgjigjën se do të zhvillohet në muajin **qershor**.

Znj. Caca theksoi se për grumbullimin e të dhënave nuk duhet të kalojnë më **shumë se gjashtë javë**, dhe se trajnimet nuk duhet të zhvillohen shumë kohë përpara procesit të raportimit. Sipas saj, duhet të krijohet një zinxhir logjik: përfundimi i trajnimit të pasohet menjëherë nga nisja e hedhjes së të dhënave në sistem.

Më pas, znj. Caca vijoi prezantimin me treguesit e sugjeruar për t’u shtuar:

1. Metra katrorë për fëmijë në çerdhe dhe kopshte publike

Komente:

Znj. Ademi u shpreh se funksioni i këtij treguesi lidhet ngushtësisht me infrastrukturën. Pas miratimit të VKM-së, bashkitë kanë filluar ta matin këtë tregues për ndërtimin e projekteve të reja. Ekziston një listë e aseteve, të cilën disa bashki e disponojnë, ndërsa të tjera jo. Ajo theksoi se ka nisur një proces regjistrimi të pronave, në bazë të VKM nr. 410, datë 26.05.2005.

Z. Xhina u shpreh se kopshtet raportojnë sipërfaqen dhe kapacitetin pranë ZVA-ve, por këto të dhëna nuk janë gjithmonë të sakta. Kapaciteti i referohet një standardi prej 2.5 metra katrorë për fëmijë në klasë. Ai shtoi se ndoshta ka ardhur momenti që edhe VKM-të të rishikohen, pasi disa

nga kopshtet e reja nuk përputhen plotësisht me standardet aktuale. Gjithashtu propozoi që ky tregues të shtohet në listën e treguesve të SMP-së, sepse pasqyron sesa të ngjeshura janë klasat për fëmijët, duke qenë një tregues i drejtpërdrejtë i lidhur me kushtet mësimore.

Znj. Nesturi u ndal tek norma e mbipopullimit në klasë, dendësinë dhe hapësirën për fëmijë. Z. Xhina përmendi se bashkia raporton një të dhënë për kapacitetin në MAS dhe sugjeroi që të emërtohet “kapaciteti i objekteve arsimore”.

2. Përqindja e institucioneve të arsimit parashkollor të rindërtuara plotësisht 5 vitet e fundit

Komente:

Znj. Caca u shpreh se duhet të ekzistojë një inventar i infrastrukturave arsimore parauniversitare (arsimi i mesëm, shkolla 9-vjeçare, kopshte dhe çerdhe) në çdo bashki. Znj. Shapo theksoi se qëllimi i SMP-së është të përzgjidhen tregues që ndikojnë dhe japin evidenca të qarta për politikëbërjen në nivel kombëtar.

Z. Kashta tha se ky tregues e nxiti nevojën për hartimin e Planit të Arsimit Parauniversitar dhe sugjeroi që të përgatitet një raport për numrin e kopshteve që janë sipas standardit dhe atyre që janë nën standard.

Znj. Caca u shpreh se ishte dakord me përfshirjen e treguesit të parë, por jo me të dytin, duke propozuar zëvendësimin me “**Numrin e infrastrukturave arsimore parauniversitare sipas niveleve arsimore në çdo bashki**”. Ajo propozoi që treguesi aktual i SMP-së për “shkallën e mirëmbajtjes së ndërtesave arsimore” të hiqet.

Znj. Shapo tha se mënyra më reale për të verifikuar këtë tregues është përmes analizës së buxhetit, por edhe lyerja e mureve me bojë konsiderohet si mirëmbajtje. Sipas saj, për të vlerësuar nëse një institucion përmbush kushtet minimale të cilësisë së jetesës për fëmijët, duhet të vlerësohen elementë konkretë, siç janë pikat sanitare (tualetet).

Përfundime

Në fund të takimit u vendos për miratimin e treguesve të cilit ishin të pandryshuar nga SMP 2023, dhe miratimin e tre treguesve të rinj për t’u shtuar:

- 1. Shkalla e regjistrimit në çerdhe;**
- 2. Shkalla e regjistrimit në kopshte publike dhe private;**
- 3. Raporti fëmijë-mësues në kopshte publike dhe private;**
- 4. Metra katrorë për fëmijë në çerdhe dhe kopshte publike në klasë;**
- 5. Numri i infrastrukturës arsimore parauniversitare sipas nivelit arsimor;**
- 6. Ekzistenca e planit vendor të arsimit parauniversitar (tregues i Grantit Bazuar në Performancë).**

Nuk u miratua treguesi mbi përqindjen e institucioneve parashkollore të rindërtuara plotësisht.